

Njësie Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Shenime shpjeguese per pasqyrat financiare

I.Informacion i përgjithshëm

Njesia ekonomike "K.A.E.XH." është krijuar si Sh.p.k, ne datë 11.01.2005, me seli në adresën: Rruga "Fadil Rada", Ap.1, pranë ish ATSH-së Tiranë.

Administrator dhe njekohesht organ drejtues i njësise ekonomike është Kapllan CUKU.

Njesia ekonomike KAEKH eshte rregjistruar dhe kryen veprimtari ekonomike me NIPT/NUIS: K71420004C

Objekti i veprimtarise se njësise ekonomike i rregjistruar ne Qendren kombetare te biznesit është:

Njesia ekonomike nuk ka bord apo organ tjeter mbikqyres.

Numri mesatar i punonjësve: **39 punonjës**

Përsori përgjegjës për përpunimin e informacionit për hartimin e pasqyrave financiare: Z. Pashk Nikoll, ekonomist i punuar ne njësinë ekonomike

Auditore Ligjore: Znj. Eleonora Olli me nr. Lijense 140, datë 28.01.2005 ;

Referuar perkufizimit te nenit 3.7 te ligjit 25/2018 date 10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" KAEKH Shpk, perkufizohet si Njesi ekonomike fitimprurese.

KAEKH shpk klasifikohet si **Njësi ekonomike e vogël bazuar ne Nenit 4.1.2. të Ligjit 25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare"** pasi ne daten e raportimit 31 dhjetor 2019, nuk tejkalon kufijtë e te pakten dy prej 3 kriterieve te nenit 4.1.2 per :

- a) Aktivin
- b) Te ardhurat nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi)
- c) Numrin mesatar te punonjesve per periudhen raportuese 1 Janar-31 Dhjetor 2019

Per hartimin e Pasqyrave Financiare, Njesia ekonomike KAEKH shpk, zbaton Standarde Kombetare te Kontabilitetit SKK bazuar ne nenin 5 te Ligjit Nr.25/2018 dt.10.05.2018 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

Pasqyrave Financiare janë hartuar sipas Standardeve Kombëtare te Kontabilitetit SKK te permiresuara Nr.2.

Parimet bazë përgatitjen e Pasqyrave Financiare janë ato te pershkruara ne SKK 1, paragrafi 40 – 90.

Parimi i njësisë ekonomike:mban në llogaritë e saj aktivet, detyrimet dhe transaksionet ekonomike të veta; Parimi i vijimësise: veprimtaria ekonomike e njësisë raportuese është e siguruar duke mos posur në plan ose nevojë ndërprerjen e aktivitetit të saj;

Kompensimi: Në përputhje me parimin e kompensimit të pëershkuar në paragrafët 64 dhe 65 të SKK 1, Parimet e përgjithshme përgatitjen e pasqyrave financiare, aktivet dhe detyrimet do të kompensohen në pasqyrën e pozicionit financier, vetëm nëse njësia ekonomike ka të drejtë ligjore t'i kompensojë aktivet dhe detyrimet si dhe ekziston mundësia që ajo ta përdorë këtë të drejtë; Të ardhurat dhe shpenzimet nuk do të kompensohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, me përjashtim të atyre të ardhurave dhe shpenzimeve që vijnë nga aktivitetet dytësore, apo që kanë ardhur nga një ose disa veprime të ngjashme, apo,që të marra veças nuk janë materiale;

Kuptueshmëria e Pasqyrave Financiare është realizuar në mosën e plotë për të qënë të qarta dhe të kuptueshme për përdorues të jashtëm që kanë njohuri të përgjithshme të mjaftueshme në fushën e kontabilitetit;

Materialiteti është vlerësuar nga ana jonë dhe në bazë të tij Pasqyrat Financiare janë hartuar vetëm për



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë
NIPT K71420004C
Shënim për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

zëra materiale.

Karakteristikat cilësore të pasqyrave financiare sipas SKK Nr.1 janë:

- Parimi i paraqitjes me besnikeri;
- Parimi i përparësisë së përbajtjes ekonomike mbi formën ligjore;
- Parimi i pa-anëshmërisë pa asnjë influencim të qëllimshëm;
- Parimi i maturisë pa optimizem të tepruar, pa nën e mbivlërësim të qëllimshëm;
- Parimi i plotësisë duke paraqitur një pamje të vërtetë e të drejtë të Pasqyrave Financiare;
- Parimi i qëndrueshmerisë për të mos ndryshuar politikat e metodat kontabël;
- Parimi i krahasushmerise duke siguruar krahasimin midis dy periudhave;

Kohëzgjatja e periudhës raportuese është 12 muaj nga data 01.01.2019-31.12.2019.

I. Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit te përmirësuar (SKKP).

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuara nga SKKP për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të performancës dhe ardhurave gjithpërfshirëse. Bazat e matjes përkruhen në detaje në politikat kontabël të mëposhtme.

Pasqyrat financiare janë përgatitur për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019.

Pasqyrat financiare janë paraqitur ne gjuhen shqipe dhe ne njesine monetare kombetare Lekë.

Krahasueshmëria

Informacioni krahasues paraqitet në mënyrë të vazhdueshme, duke aplikuar politikat kontabël të njësise ekonomike dhe duke u bazuar në modelin e pasqyrave financiare sipas sistemit kombetar kontabël. Të dhënat krahasuese pasqyrojnë gjendjen e pozicionit finansiar të shoqerise ne 31 Dhjetor 2018.

Qëndrueshmëria e Paraqitjes

Njësia ekonomike ruan paraqitjen dhe klasifikimin e zërave në pasqyrat financiare nga njëra periudhë në tjetrën.

Njësia ekonomike në vijimësi

Pasqyrat financiare të njësise ekonomike janë përgatitur mbi supozimin e parimit të vijimësise, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar mbi 12 muaj.

Me 31 Dhjetor 2019 vlera e aktiveve afatshkurtra është 387851 mijë Lek dhe Vlera e detyrimeve afatshkurtra është 97283 mijë Leke dhe tregojne se njësia ekonomike me aktivet e saj mund te shlyje detyrimet afatshkurtera.

Aksioneri, ortaku i vetem i njësise ekonomike dhe përfituesi i kapitalit aksioner të shoqërise "KAEXH" Shpk shpreh gotishmërinë që shoqëria të plotësojë detyrimet financiare në çdo kohë dhe t'i sigurojë osaj gjithë mbështëtjen që mund të nevojitet për të mbajtur nivelin e kapitalit dhe likuiditetit në nivele të tillë që të përbushin shlyerjen e detyrimeve në përputhje me parimin e vijimësë të përshtatshem për aktivitetin që kryen njësia ekonomike.

Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SKKP-t kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, çmuarje dhe supozime të cilat ndikojnë në zbatimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet faktike mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësimet.



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënim për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Çmuarjet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vozdueshme. Rishikimet e çmuarjeve kontabël nijhen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës në të cilin është kryer transaksi. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e mbylljes së bilancit janë rivlerësuar në monedhën funksionale sipas kursit të shpallur nga Banka e Shqipërisë në datën e mbylljes së periudhës ushtimore. Diferencat që rrjedhin si rezultat i rikonvertimit nijhen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat kryesore të perdonura në konvertimin e gjendjeve të bilancit emërtuar në monedhe të huaj në datën e hartimit të Pasqyrave Financiare janë si më poshtë (në LEK):

	31.12.2019	31.12.2018
Kurse e kembimit		
Euro/Leke	121.77	123.42
USD/ Leke	108.64	107.82
GBP/Leke	143.00	132.98

II. Politikat kontabile

1. Instrumentat financiare

Instrument finansiar është çdo kontratë që krijon një aktiv finansiar për një njësi ekonomike, si dhe një detyrim finansiar ose instrument kapitali për një njësi ekonomike tjetër.

Instrumentat finansiarë të shoqërise përbëhen nga: mjetet monetare; një instrument borxhi (si llogari, hua e arkëtueshme ose e pagueshme) që plotësojnë kushtet në paragrafin 7 të SKKP nr.3; një zotim për të marrë një hua e cila: (i) nuk mund të paguhet në para, dhe (ii) kur zotimi realizohet, pritet që ai të plotësojë kushtet e dhëna në paragrafin 7 SKKP nr.3.

Njohja fillestare

Një instrument finansiar nijhet nëse shoqëria bëhet palë e kushteve kontraktuale të instrumentit ne fjalë. Blerjet dhe shitjet normale të instrumentave finansiar kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë instrumentin finansiar. Instrumentat finansiarë nijhen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksi që lidhet me to, përveç rasteve nëse përcaktohet ndryshe, për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet filim/humbje, kostot e transaksionit kalojnë në shpenzime dhe të ardhura.

Vlerësimi i mëpasshëm

Në vijim të njohjes fillestare instrumentat finansiarë maten siç përkruhet më poshtë.

Paraja dhe mjetet monetare ekuivalente me to

Paraja dhe ekvivalentët e parosë (mjetet monetare) përfshijnë para ne arkë, depozitat në para në bankat, investime të tjera likuide me maturim fillesttar prej tre ose më pak muajsh. Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.3.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme nijhen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Vlerësimi i shumave të pambledhshme bazohet në gjykimin e drejtimit. Në fund të periudhës Shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK Nr.3.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar. Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.3.



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Huadhënie dhe huamarri

Huate e Dhëna: Huate e arkëtueshme janë aktive financiare jo-derivative me pagesa të përcaktuara sipas kushteve kontraktuale me pagesa fikse dhe variabel në varësi të normave të interesit të cilat nuk janë të kuotuara.

Pas matjes fillestare, të tilla aktive financiare maten në vazhdim me kosto te amortizuar.

Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Huate e marra: Huatë (detyrime financiare), janë njohur fillimisht me vlerën e tregut plus kostot e transaksioneve dhe me pas njihen me koston e amortizuar.

Shpenzimet interesit të llogaritur me normën interesit efektive (NEI) i cili pasqyrohet në rezultat llogariten me vleren e drejtë dhe pasqyrohen ne pasqyrën e të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Kostot e huamarries që lidhen drejtperdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve kualifikuese, të cilat janë aktive që kërkojnë domosdoshmerish një periudhë të madhe kohe për t'u bërë gati për përdorimin e tyre përfundimtar ose për shitje mund ti shthen kostos së këtyre aktiveve deri në momentin që këto aktive janë kryesisht gati për t'u përdorur ose shitur.

Netimi i instrumentave financiare

Aktivet dhe detyrimet financiare netohen dhe shuma neto e tyre raportohet në pasqrot financiare nëse, dhe vetëm nëse ka një të drejtë të detyrueshme ligjore për të netuar shumën e njohur dhe ekziston mundësia per të shlyer në shumen neto, apo për të realizuar aktivin dhe shlyer pasivet njëkohësisht.

Zhvlerësime të aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet si i zhvlerësuar në ato raste kur ekzistojnë kushte objektive që tregojnë se një apo më shume ngjarje (pas njohjes së tij fillestare) kanë efektë negative në flukset e ardhshme të parosë që parashikohet të burojnë prej atij aktivi. Vështirësitet e konsiderueshme financiare të debitorit, probabiliteti që debitori do të falimentojë apo një riorganizim financiar, dhe pamundësia apo shkeljet në pagesa konsiderohen si tregues që një llogari e arkëtueshme është e zhvlerësuar.

Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.3

Ç'regjistrimi instrumentave financiare

Aktivet financiare se bashku me fondin rezerve të zhvlerësimit ç'regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parosë së aktivit finanziar ose kur shoqëria transferon aktivin finanziar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfilitimet thelbësore të aktivit.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërise perfundojnë, skadojnë, shfuqizohen ose anullohen.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Vlera e drejtë e llogarive të arkëtueshme, duke përjashtuar ndërtimet në proces, vlerësohet si vlera aktuale e flukseve të ardhshme të parosë, të skontuara me normën e interesit në treg në datën e raportimit.

Instrumentat finansiarë janë klasifikuar si detyrime afat-shkurtra përvëç rostit kur shoqëria ka një të drejtë të pakushtëzuar për shtyrjen e shlyrjes së detyrimit për të paktën 12 muaj pos datës së bilancit.

2. Inventaret

Inventaret regjistrohen ne kontabilitet me kosto e marries perfshin te gjitha shpenzimet e kryera per sjelljen e inventarit ne vendin e percaktuar. Ne rostin e prodhimit te produkteve, ne kosto perfshihet dhe pjesa respektive e shpenzimeve te pergjithshme duke i llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Per percaktimin e kostos se inventareve është zgjedhur metoda e kostos mesatare. Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.2



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënim për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

3. Aktivet Afatgjata Materiale (AAM) dhe Jomaterilae (AAJM)

Njohja dhe Matja : Vlerësimi filletar i një elementi te AAM-ve që plotëson kriteret për njohje si aktiv në pasqyrat financiare është vlerësuar me koston e marrjes ose të prodhimit të tyre. Kosto e marrjes përfshin te gjitha shpenzimet e kryera për sjelljen e aktiveve në vendin dhe kushtet ekzistuese (SKK 5).

Njohja Mepashme: AAM-të paraqiten me kosto minus amortizimin e akumular dhe ndonjë humbje të akumular nga zhvlerësimi (SKK 5).

Nëse një pjesë e një elementi të AAM-së zëvendësohet, kostoja e pjesës së re i shtohet kostos së elementit, nëse ajo përbush kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret e njohjes së aktiveve. Pjesa e zëvendësuar do të hiqet edhe në se ajo nuk është kontabilizuar si pjesë më vete. Nëse kosto fillestare (rrjedhimisht, edhe vlera kontabёl aktuale) e pjesës së zëvendësuar nuk dihet ajo mund të vlerësohet në bazë të kostos aktuale të kësaj pjesë minus amortizimin e vlerësuar.

Amortizimi: Për llogaritjen e amortizimit të AAM-ve njësia ekonomike ka përdorur metodën e amortizimit mbi bozën e vlefthës se mbetur te AAM-ve. Normat e amortizimit të përdorur janë ne perputhje me normat e percaktuara ne ligjin 8438 date 28.12.1998 "Per tatimin mbi te ardhurat", i ndryshuar, si më poshtë:

Nr	Lloji i AAM	Norma e amortizimit	Metoda e aplikuar
1.	Mjete Transporti	20%	Me vlerë të mbetur
2.	Instalime teknike, makineri e pajisje	20%	Me vlerë të mbetur
3	Pajisje informatike, softëer	25%	Me vlerë të mbetur

Tokat dhe Investimet në proces nuk amortizohen.

Ç' regjistrimi: Një zë i aktiveve afatgjata materiale ç' regjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerra e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet ne rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të ushtrimit.

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria vlerëson në datën raportimi nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Aktivet Afatgjata Jo-materiale (AAJM-t)

Aktivet afatgjata jomateriale perfshijnë licensat, të drejtat për përdorim dhe emri i mire.

Njohja dhe Matja: Licensat, të drejtat e përdorimit të cilat përfshihen nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumular dhe humbjet e akumulara nga zhvlerësimi, nëse ka.

Shpenzime te Mëpasshme: Shpenzimet pasuese kapitalizohen vetëm në rastin kur shtojnë përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin specifik me të cilat ato lidhen. Të gjitha shpenzimet njihen si fitim apo humbje në momentin kur kryhen.

Amortizimi: Amortizimi njihet në pasqyren e të ardhurove dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare mbi jetëgjatesinë e parashikuar (SKK 5) të aktiveve të patrupëzuara që nga data që janë të disponueshme për përdorim.

AAJMateriale	Norma e Amortizimit	Metoda e aplikuar
Koncesione,patenta,licensa, etj	20%	Me vlerë të mbetur



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënim për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Zhvlerësimi (Rënia në vlerë): Shoqëria e vlerëson në datën e raportimit nëse ka premisa që një aktiv të zhvlerësohet.

Në fund të periudhës shoqëria nuk ka aplikuar vlerësim sipas SKK.Nr.5

4. Provigionet

Provigionet njihen kur njësia ekonomike ka një detyrim aktual (ligjor ose të tërthorte) si rezultat i një ngjarjeje të shkuar përfundimtare që të krijojen një rrjedhë burimesh të nevojshme përfundimtare. Provigionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më mundësi përfundimtare nevojë e një rrjedhe burimesh që përfshin përfitime ekonomike përfundimtare. Provigionet rimerren. Provigionet përdoren vetëm përfundimtare qëllimin përfundimtare.

Pasivet dhe aktivet e kushtëzuara nuk njihen, por vetëm paraqiten në shënimet e pasqyrave financiare të ndermjetme kur janë materiale. Njësia ekonomike nuk ka provigjione.

5. Qiratë

Qirotë klasifikohen si qira financiare ose qira operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën me më të voglën midis vlerës së drejtë të aktivit dhe vlerës aktuale të pagesave minimale të qirasë në datën e marrjes. Kosto financiare paraqet diferençën midis detyrimit total të qirasë dhe vlerës së drejtë të aktivit. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë kohëzgjaljes së qirasë me norma interesit të aplikueshme mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Shoqëria nuk ka qira financiare.

6. Transaksionet me palët e lidhura

Palë të lidhura janë ato, kur njëra prej paleve kontrollohet nga pala tjeter ose ka influencë të rëndësishme në vendimarrjen financiare ose të biznesit të palës tjeter.

7. Të Ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat

Të ardhurat njihen në mosën që është e mundur që përfitime ekonomike do të hyjnë në shoqëri dhe që të ardhurat mund të maten në mënyrë të besueshme, pavarsisht se kur bëhet pagesa. Të ardhurat maten me vlerë të drejtë të mallit/sherbimit të shitur neto nga tatimi mbi vlerën e shtuar dhe zbritje të mundshme të shitjeve.

Shpenzimet

Njësia ekonomike njeh shpenzimet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në proporcione kryerjen e tyre në datën e raportimit. Shpenzimet paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas natyrës së tyre, çka kërkon gjykim të konsiderueshem nga drejtimi i shoqërisë.

Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesit nga llogaritë me banka dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesit njihen kur maturohen duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesit mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit. Gjithashtu ne kete grup te ardhurash, Shoqëria ka perfshire edhe blerje AAM nepermjet dhurimit. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.



Njësie Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi apo humbjet e vitit përbëhet nga tatimi aktual. Tatim fitimi nijhet në pasqyrën e të ardhurove dhe shpenzimeve përvèç rasteve kur lidhet me zëra që nijhen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi nijhet në kapital. Tatimi aktual është tatimi i pritur per t'u paguar mbi fitimin e tatushem te vitit, duke aplikuar normat tatumore ne fuqi ne daten e raporimit te Pasqyrave Financiare, si edhe çdo lloj rregullimi kontabel të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme.

Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2019 dhe 2018 paraqiten më poshtë:

31.12.2019 31.12.2018

Tatim Fitimi	15%	15%
--------------	-----	-----

9. Dividendë

Shpërndarja e dividendëve për aksionerët e njësise ekonomike nijhet në pasqyrat financiare si detyrim i periudhës në të cilën janë oprovuar nga aksionerët e njësise ekonomike.

10. Kapitali i Vet

Kapitali i nënshkruar përfaqëson kontributin e ortakeve në datën e krijuar të shoqërisë dhe ndryshimet gjatë veprimtarisë. Kapitali aksioner nijhet me vlerën nominale.

11. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet për sigurimet e detyrueshme shoqërore që sigurojnë pension për punonjësit. Qeveria shqiptare është pergjegjëse për caktimin e minimumit të kontributit për sigurimet shoqërore në Shqipëri sipas një plani pensioni bazuar në kontribute. Kontributet e shoqërisë në planin e pensionit janë pasqyruar në pasqyrën e të ardhurove dhe shpenzimeve kur ndodhin.

Leje vjetore e paguar

Shoqëria njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostove te çmuara lidhur me lejen vjetore për tu paguar ne këmbim te shërbimit të punonjësit për periudhën e përfunduar.

12. Ngjarje pas mbylljes së pasqyrave financiare

Ngjarjet pas datës se mbylljes se pasqyrave financiare që përbajnë informacion shtesë të njësise ekonomike, në datën e mbylljes se tyre (ngjarjet rregulluese) janë reflektuar në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas bilancit që nuk janë ngjarje rregulluese paraqiten të shpalosura në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare kur janë materiale.

13. Mjetet Monetare

13.1. Bankat

Nr	Banka	Monedha	Nr. llogari Bankare	Vlera ne Valute	Kursi I kembimit	31 Dhjetor 2019 Vlera ne Leke	31 Dhjetor 2018 Vlera ne Leke
1	BKT	Lek	401066712			3 3061 635.76	3 542 292.44
2	BKT	Euro	401066712	356.23	121.77	43 378.13	4 288.85
3	TR Bank	Lek	0100-306186-100			105 361.69	58 234.21



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

4	TR Bank	Euro	0100-306186-101	134.00	121.77	16317.18	514 661.40
5	Credins Bank	Lek	00000094804			196 418.06	4 082.08
6	Credins Bank	Euro	00000860590	1 097.86	121.77	133 686.41	6 188.28
7	ProCredit Bank	Euro	088077500002	2 721.37	121.77	331 381.22	2 453 295.86
8	Intesa SP Bank	Lek	20852035301			74 213.56	80 213.56
9	Intesa SP Bank	Euro	20852035302	9.31	121.77	1 133.68	5 904 343.68
10	Raiffeisen Bank	Lek	0001383384			249 841.00	0.00
11	Raiffeisen Bank	Euro	0011383384	144.36	121.77	17 578.72	1 234.20
Totali						34 230 945.41	12 568 834.56

13.2. Arka

Nr	Arka	Monedha	Vlera ne Valute	Kursi i kembimit	31 Dhjetor 2019 Vlera ne Leke	31 Dhjetor 2018 Vlera ne Leke
1	Arka	Lek			48063.38	10296.70
2	Arka	Euro	237.4	121.77	28908.20	60846.06
	Totali				76971.58	71142.76

Veprimet e lëvizjeve monetare në librat e arkës dhe bankës, janë veprime të autorizuara, mbështetën në dokumenta që jasifikojnë pagesat dhe arkëtimet, regjistrimet janë kronologjike. Për gjendjen në valutë është bërë rivlerësimi me kursin fiks të bankës së Shqipërisë në datën 31.12.2019 dhe diferenca janë pasqyruar në llogarite e rezultatit ne pasqyren e performancës .

14. Te drejta te arketueshme dhe te tjera te arketueshme (Tabela)

Nr	Te drejta te arketueshme	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Klientë nën 1 vit	143 919 524	69 817 837
2	Klientë mbi 1 vit	102 269 161	91 289 482
	Totali	246 188 685	161 107 319

15. Inventare

Inventare	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
	Vlera ne Leke	Vlera ne Leke
Lende e pare dhe materiale konsumi	725 764	0
Objekte inventari	422 339	330 329
Totali	1 148 103	330 329



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënim për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Njësia ekonomike ka kryer inventarin fizik te lendet se pare dhe materialeve te konsumit ne muajin dhjetor 2019 duke kontrolluar ne kete menyre ekzistencen e inventarit.

16. Aktive Financiare

Aktive Financiare Afatgjata	31 Dhjetor 2019		31 Dhjetor 2018	
	Vlera ne Leke		Vlera ne Leke	
Tituj te tjere te huadhenies	2 830 000		2 830 000	
Totali	2 830 000		2 830 000	

17. Aktive Afatgjata Materiale (Tabela VI Fillestare , Amortizimi Vlera e Mbletur)

Aktivet Afatgjata Materiale me vlera Fillestre

Nr.	Emertimi	Gjendja me 01.01.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje me 31.12.2019
1	Mjete Transporti	25 346 642	0	6 893 112	18 453 530
2	Pajisje zyre, informatike, makineri e pajisje te tjera	4 471 522	721 444	0	5 192 966
	Totali	29 818 164	721 444	6 893 112	23 646 496

Amortizimi viti 2019

Nr.	Emertimi	Gjendja me 01.01.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje me 31.12.2019
1	Mjete Transporti	8 920 044	3 170 120	5 969 436	6 120 728
2	Pajisje zyre, informatike, makineri e pajisje te tjera	1 810 230	636 779	0	2 447 009
	Totali	10 730 274	3 806 899	5 969 436	8 567 737

Vlera Neto e Aktiveve Afatgjata Materiale

Nr.	Emertimi	Gjendja me 01.01.2019	Shtesa	Pakesime	Gjendje me 31.12.2019
1	Mjete Transporti	16 426 598	-3 170 120	923 676	12 332 802
2	Pajisje zyre, informatike, makineri e pajisje te tjera	2 661 292	84 665	0	2 745 957
	Totali	19 087 890	-3 085 455	923 676	15 078 759



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Njesia ekonomike ka kryer inventarin fizik te aktiveve Afatgjata Materiale : Pajisje e makineri, mjete transporti, inventar ekonomik ne muajin dhjetor 2019, duke kontrolluar ne kete menyre ekzistencen e tyre.

18.Detyrime afatshkurteria

Nr	Detyrime afatshkurteria	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Arkëtime në avancë për porosi	14 517 375	0
2	Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit	52 400 377	19 685 534
2.a	Furnitorë nën 1 vit	26 832 742	12 461 013
2.b	Furnitorë mbi 1 vit	25 567 635	7 224 521
3	Të pagueshme ndaj njësive ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse (dividentë)	738 955	0
	Totali	67 656 707	19 685 534

Njësia ekonomike parashikon në një ecuri normale të biznesit që të mbylli detyrimet ndaj furnitorëve brenda viti ushtrimor 2020.

Detyrimet tatimore

Nr	Detyrime tatimore	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Tatim te ardhura personale	214 394	152 100
2	Tatim mbi Fitimin sipas bilancit	6 232 265	0
3	Tatim mbi Vleren e Shtuar	22 653 068	6 964 451
4	Tatim ne Burim (qeraje)	6 075	6 075
	Totali	29 105 802	7 122 626

Detyrimet per personelin dhe sigurimet

Nr	Detyrime tatimore	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Paga dhe shperblime te punonjesve (parapagim page e pambyllur)	-11 020	218 404
2	Kontributi te sigurimeve shoq.e shendet.	531 657	330 678
	Totali	520 637	549 082



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

19.Detyrime afatgjata

Nr	Detyrime afatgjata	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë (leasing ne Credins Bank)	1 303 032	1 938 195
2	Detyrime ndaj institucioneve të kredisë (leasing ne Raiffeisen Bank)	4 222 273	6 294 420
	Totali	5 525 305	8 232 615

20.Totali i kapitalit

Nr	Kapitali	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Kapitali i nenshkruar	35 000 000	35 000 000
2	Rezerva ligjore	1 746 672	1 746 672
3	Rezerva statutore (fond per investime)	193 226 009	192 549 888
4	Fitimi i viti ushtrimor	73 016 057	30 676 121
	Totali	302 988 738	259 972 681

Kapitali i njesise ekonomike me vlerë totale 35 000 000 leke eshte ne zoterim 100% te ortakut te vetem Kapllan Cuku.

Nr i pjesave te kapitalit 100, vlera nominale e nje pjesë 35 000 lek.

21.Te ardhurat nga aktiviteti

Nr	Te ardhura nga aktiviteti	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Te ardhura nga aktiviteti i ndërtimit, Tregeti, Sherbime	188 613 449	187 422 911
	Totali	188 613 449	187 422 911

22.Te ardhura te tjera financiare

Nr	Te ardhura	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Te ardhura nga interest bankare	18	2 048
2	Fitime nga kembimet valutore	167 657	734 291
3	Te ardhura te tjera (shitje e AAGJM)	813 264	2 232 646



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

4	Te ardhura te tjera (korrigjim T.Fitimi)	0	42 377
5	Te ardhura te tjera (blerje AAGJM nepermjet dhurimit)	70 813	0
	Totali	1 051 752	3 011 362

23.Shpenzimet materiale

Nr	Shpenzime materiale	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Lende e pare dhe materiale konsumi	25 759 493	64 535 449
2	Te tjera shpenzime (Uje ,Energji)	65 004	0
	Totali	25 824 497	64 535 449

24.Shpenzime per personelin

Nr	Shpenzime per personelin	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Paga dhe shperblime	19 065 340	15 605 366
2	Shpenzime per sigurime shoqerore dhe shendetësore	2 894 032	2 386 718
	Totali	21 959 372	17 992 084

Shpenzimet e punësimit (pagot dhe sigurimet shoqërore & shëndetësore) janë dokumentuar dhe paraqitur në shpenzimet për personelin, gjithashtu edhe detyrimet ne perputhje me legjislacionin tatumor për punëmarrësit në lindje me pagën e përfituar janë dokumentuar dhe paraqitur saktë në Pasqyrat Financiare.

25.Shpenzime amortizimi

Nr	Shpenzime amortizimi	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Amortizimi vjetor	3 816 200	2 616 963
	Totali	3 816 200	2 616 963

26.Shpenzime te tjera te shfrytezimit

Nr	Shpenzime te tjera	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Punime e sherbime nga te tretet	47 584 275	53 206 410



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

2	Sherbime t tjera	917 087	8 377 637
3	Tatime e taksa	278 059	220 033
4	Shpenzime te tjera te veçanta korente	633 459	980 524
5	Shpenzime te tjera jokorente (shitia e AAM)	923 677	2 161 306
	Nga shpenzimet: - Tarifa te auditimit ligjor	480 417	330 387
	Totali	50 336 557	64 945 910

Ne periudhen raportuese njësia ekonomike ka kryer shpenzime vetem per tarifen e auditimit ligjor te pasqyrave financiare 2018. Njësia ekonomike nuk ka kryer sherbime te tjera te sigurise ose sherbime keshillimore tatimore dhe te tjera sherbime joauditimi.

27. Shpenzime te tjera financiare

Nr	Rezultati	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Shpenzime interes i per qerane financiare	349 512	175 329
2	Shpenzime financiare te tjera (sipas vleresimit nga KLSH per Avokat. Shtetit)	0	111 888
3	Humbje nga kembimet valutore dhe Azhornimet njësi likujdimi	925 309	3 623 170
	Totali	1 274 821	3 910 387

28. Rezultati Financiar dhe Fitimi neto

Nr	Rezultati	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Rezultati/Fitimi para tatimit	86 453 754	36 433 480
2	Shpenzime te panjohura	3 130 895	1 948 917
3	Fitimi i Tatueshem	89 584 649	38 382 397
4	Tatim fitimi 15%	13 437 697	5 757 359
	Fitimi Neto	73 016 057	30 676 121



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

28. Shpenzime te pazbritshme

Nr	Shpenzime te pazbritshme	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
1	Gjoba	17 941	286 120
2	Shpenzime pa dokumenta justifikuese	212 307	7 640
3	Paga e shperblime paguar jo nepermjet llogarise bankare	2 741 411	1 031 992
4	Blerje dhe sherbime te panjohura	159 236	623 165
	Totali	3 130 895	1 948 917

Analiza dhe rakordimi i detyrimit per Tatimin mbi Fitimin

- Tatim Fitimi sipas bilancit viti 2018 5 728 438 Lek
 - Keste Tatim Fitimi paguar per vitin 2019 1 476 994 Lek
 - Tatim Fitimi sipas bilancit te vitit 2019 13 437 697 Lek
- Detyrim per Tatim Fitimin 31/12/2019** 6 232 265 Lek

Rakordimi me sistemin tatimor

Analiza dhe rakordimi i Shitjeve dhe Blerjeve

31 Dhjetor 2019

Rakordimi i të ardhurave me FDP-në e Tatim Fitimit

Shitje total të deklaruara në FDP TVSH	203 944 088
Parapagime te marra e te pambyllura	14 517 375
Shitje të deklaruara në FDP që janë të ardhura në PASH	189 426 713
Të ardhura nga interesat dhe te tjera financiare	238 488
Total të ardhura të deklaruara FDP e Tatim Fitimit	189 665 201



Njësia Ekonomike "K.A.E.XH." Shpk, Tiranë

NIPT K71420004C

Shënimë për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

31 Dhjetor 2019

Rakordimi i shpenzimeve me FDP-në e Tatim Fitimit

Blerje total të deklaruara në FDP e TVSH	90 150 015
Parapagim për blerje materiale e shërbime	11 888 215
Zbritet Blerje Asete	721 444
Blerje/Shpenzime per Qera Financiare	2 707 210
Rritje gjendje inventari 31/12/2019	817 775
Shpenzime të deklaruara në FDP	74 015 371

Shpenzimet të deklaruara në FDP që janë shpenzime në PASH 74 015 371

Diferencia:

Detajim i diferencës së padëklaruar:

- Paga e kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	21 959 372
- Amortizime të AAGJ	3 816 200
- Udhëtim e dieta për punonjësit	516 842
- Taksa e tarifa të ndryshme	281 419
- Shërbime bankare	128 701
- Shërbime të tjera korente e jokorente	1 299 133
- Qera objekti	269 100
- Humbje nga këmbimet/përkhimet valutore	925 309

Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2019 Shoqëria/subjekti nuk ka osnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ojo, që mund të kërkoje rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

Detyrime tatimore

Librat e Shoqërisë/subjektit nuk janë audituar nga organet tatimore për periudhën 2019. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

Ngjarje pas datës se bilancit

Me 31 Dhjetor 2019 në datën e pasqyrave financiare dhe deri në datën e aprovimit të tyre nuk ka ngjarje rregulluese të reflektuara në pasqyrat financiare ose ngjarje që janë materialisht të rëndësishme për të paraqitur në këto pasqyra.

Hartuesi i Pasqyrave Financiare

Pashk Nikollli

ADMINISTRATORI

